URDHËR
Nr. 332, datë 13.7.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për nënshkrimin e urdhrit "Për miratimin dhe transferimin e menaxhimit të tregut të shitjes me shumicë të produkteve të peshkimit, në Portin e Peshkimit Shëngjin, Lezhë", zëvendësministrit Roland Kristo.

2. Zëvendësministri Roland Kristo të monitorojë:

- veprimtarinë e komisionit ngritur me urdhrin nr. 46, datë 14.2.2022, "Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e propozimit për transferimin e menaxhimit të tregut të shitjes me shumicë të produkteve të peshkimit në Portin e Peshkimit Shëngjin, Lezhë";
- procesin e negocimit të projektmarrëveshjes dhe të nënshkruajë marrëveshjen e dakordësuar;
- procesin pas nënshkrimit të marrëveshjes për përmbushjen e detyrimeve, transferimin e menaxhimit, kalimin e aseteve dhe dokumentacionit te Bashkia Lezhë;
- zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar me qëllim garantimin e menaxhimit në zbatim të marrëveshjes dhe në përputhje me legjislacionin sektorial;
- koordinimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit, në lidhje me funksionimin e menaxhimit të Portit pas nënshkrimit të marrëveshjes.

3. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë kompetencat e përfituara përmes këtij akti.

4. Ngarkohet zëvendësministri Roland Kristo për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për njoftimin e urdhrit Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca